

## KOMUNA E LIPJANIT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Në vitin 2013, fitues në garën për kryetar komune dhe asamble komunale kanë dalë Imri Ahmeti dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pas dy mandateve që kjo komunë qeverisej nga PDK.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>1</sup> Mbi 95% e qytetarëve të Lipjanit besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga probleme me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.<sup>2</sup>

Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2013, problemet kryesore në Komunën e Lipjanit kanë qenë: ndotja e lumit "Sitinca", mungesa e objekteve shkollore, gjendja e keqe e objekteve shkollore, mos mirëmbajtja e ndërtesave publike, mungesa e ngrohjes qendrore për ndërtesat kolektive dhe deponitë ilegale të mbeturinave dhe papastërtia në qytet.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësishë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 20 qershor 2017)

<sup>3</sup> Instituti GAP, Komuna e Lipjanit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor 2013, Burimi: <http://bit.ly/2rPFtF2>

## Problemet aktuale në Komunën e Lipjanit

### **Ndotja e lumit "Sitnica"**

Lumi kryesor që përshkon komunën e Lipjanit është "Sitnica". Në të derdhen disa lumenj të vegjël dhe përroska, burimi i të cilave është nga malet përreth. Më të rëndësishmet janë lumenjtë "Janjevka", "Zegorka" dhe "Gadimja". Gati të gjithë lumenjtë janë të ndotur. Ndotja shkaktohet nga hedhja e vazhdueshme e mbeturinave në shtratin e lumit si dhe nga derdhja e kanalizimeve përgjatë vijës së shtretërve të lumenjve. Edhe pse komuna gjatë këtij mandati ka ndërtuar dy kolektorë për rehabilitimin e ujërave të zeza (Kolektori I: Rehabilitimi i Rrjeteve të kanalizimeve në fshatrat Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Poturovc, Torinë, Dobrajë e Madhe, Llugë (kolektori përmbledhës), me gjatësi rreth 6,600 metra dhe Kolektori II: Rehabilitimi i kanalizimit në fshatin Bujari (kolektor përmbledhës për kanalizimet e Smallushës, Qollapek, Marec, Gllavic, Llugaxhi dhe Kojskë), me gjatësi 8,000 metra), në mungesë të impianteve derdhja e këtyre ujërave bëhet në lumin "Sitnica".

### **Mungesa e ujit të pijes nëpër fshatra**

Edhe pse komuna ka ri-funksionalizuar ujësjellësin në fshatrat Magurë, Janjevë dhe Medvec, banorët e këtyre fshatrave ankohen për mungesë të ujit të pijes. Në komunën e Lipjanit ka akoma fshatra që nuk janë të përfshira në rrjetin e ujësjellësit si Topliqani, Grackë e vogël, Kraishta, Zllakuqan, Krojmir, Rusinovc, etj.

### **Vonesa në funksionimin dhe parregullsitë në zonat ekonomike**

Komuna e Lipjanit ka të shpallura katër zona ekonomike. Zona ekonomike industriale Lipjan – QMI në sipërfaqe prej 87 hektarësh, Zona ekonomike "Parku Industrial" në Kerqevë në sipërfaqe prej 139 hektarësh, Zona Mikse R120 në sipërfaqe prej 61 hektarësh, dhe Zona e Aeroportit (ZE – A), 190 hektarësh. Në zonën ekonomike "Parku Industrial" në Kerqevë, ka pasur vonesa për licencimin e kësaj zone nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për arsye se legjislatura e kaluar ka paraparë shndërrimin e tokave private në zona ekonomike. Andaj, për këtë arsye është dashur të rikthehet në kuvend komunal vendimi i marrë i asaj kohe që shndërrimi i tokës në zonë ekonomike të bëhet vetëm në toka komunale, siç parashihet edhe me ligj. Kjo zonë, në maj të 2017, ka marrë pëlqimin e MTI-së, e cila në bashkëfinancim me komunën do të investojë në ndërtimin dhe funksionalizimin e kësaj zone. Ndërsa, në zonën ekonomike QMI ka parregullësi në zbatimin e kontratës. Ka toka të cilat i janë dhënë në shfrytëzim investitorëve privat, të cilët nuk kanë investuar fare në këtë zonë siç është paraparë në kontratë. Andaj komuna është detyruar të ndërmarrë hapa për rikthimin e këtyre tokave.

### **Mos mirëmbajtja e ndërtesave publike**

Në qendër të qytetit të Lipjanit, përgjatë rrugës kryesore "Lidhja e Prizrenit" dhe në zonën "Adem Jashari" ekzistojnë disa ndërtesa publike të ndërtuara para viteve '90-ta. Këto ndërtesa nuk janë gëlqerosur asnjëherë pas periudhës së luftës, po ashtu nuk kanë ndriçim të jashtëm apo ndriçim në shkallët e brendshme. Dritaret e korridoreve dhe të shkallëve vërehen të thyera. Banorët në këto ndërtesa kanë shfrytëzuar edhe hapësirat e jashtme, ballkonet, për t'i shndërruar ato në dhoma duke e prishur kështu strukturën e ndërtesës. Njësoj është gjendja me ndërtesën në kryqëzimin e rrugës Magurë – Medvec.

### **Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje**

#### **Gëlqerosja e ndërtesave të vjetra**

Qendra e qytetit të Lipjanit përshkohet me disa ndërtesa të stilit të vjetër të cilat në masë të madhe janë të shkatërruara. Kjo pamje shëmton pasqyrën e qytetit dhe kështu autoritetet komunale do të duhej në katër vitet e ardhshme të parashohin mundësinë e gëlqerosjes së këtyre ndërtesave ose izolimit me qëllim të përmirësimit të pamjes së qytetit.


### **Trendet buxhetore në Komunën e Lipjanit (2017)**

Komuna e Lipjanit në vitin 2017 ka planifikuar 14 milion euro buxhet.<sup>4</sup> Përveç planifikimit të rregullt buxhetor Komuna e Lipjanit ka bartur edhe rreth 758 mijë euro nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur 249 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Lipjanit ka pasur një rritje buxhetore prej 2 milion euro. Rritja e buxhetit krahasuar 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) është bërë në kategorinë e pagave, investime kapitale dhe mallra dhe shërbime. Kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga 6.7 milionë euro më 2013 në 8.8 milionë euro më 2017. Ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2017 Lipjani ka në dispozicion rreth 3,9 milionë euro apo 7% rritje të buxhetit krahasuar me vitin 2013.

---


<sup>4</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rPLsJĚ>

**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Lipjanit 2017



Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme. Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Lipjanit është rritur për 25 persona në vitin 2016. Përveç numrit të rregullt të punëtorëve, në komunë janë punësuar 23 persona me kontratë për shërbime të veçanta gjatë vitit 2016.


**Figura nr.2:** Trendët buxhetore në Komunën e Lipjanit 2013-2017



Komuna e Lipjanit në vitin e fundit (2016) ka rritur në mënyrë të ndjeshme nivelin e të hyrave komunale. Gjatë këtij viti janë realizuar 1.8

milione euro të hyra, apo rreth 355 mijë euro më shumë se gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2015.

**Figura nr.3:** Të hyrat komunale 2013-2016



**Burimi:** Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Lipjanit duhet të investojë në zgjidhjen e problemeve nga ujërat e zeza, veçmas shmangien e derdhjes së tyre në lumin e qytetit.
- Komuna e Lipjanit duhet të gjejë burime të reja të ujit dhe shpërndarjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatra.
- Komuna e Lipjanit duhet të finalizojë investimet e nisura në zonën ekonomike të qytetit dhe të mundësojë funksionimin gradual të kësaj zone.
- Komuna e Lipjanit duhet të shohë me prioritet rregullimin e pamjes së qytetit, veçmas gëlqerosjen e ndërtesave të vjetra në qytet.
- Komuna e Lipjanit duhet t'i rrisë të hyrat komunale në kategorinë e shfrytëzimit të hapësirave publike ngase nga kjo kategori kjo komunë ka pak të hyra, ndonëse hapësirat publike të shfrytëzuara nga lokalet hoteliere në vitet e fundit kanë pasur rritje.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*